methacrylate/acrylonitrile/butadiene/styrene	akrilonitril-metakrilat-butadien-stiren	komponim që ka në përbërje akrilonitril-metakrilat-butadien-stiren
methane	metan-i	hidrokarbur gazor i përfunduar me pastrim të lëndëve organike
methanol	metanol-i	perparat që përdoret si tretës ose lëndë e parë në industri
method	metodë	tërësi rregullash e mjeteve për të studiuar ose arritur një qëllim
methodology	metodologji	tërësi metodash që përdoren në një fushë të caktuar
methods	metoda-t	tërësi metodash
methyl	metil-i	radikat monovalent si derivat i metanit
methylene	metilen-i	derivat i metanit
metric	metrik-e	që lidhet me metrin si njësi matëse

metrological	metrologjik-e	që lidhet me metrologjinë
metrology	metrologji	shkencë dhe teknikë e matjeve dhe instrumenteve të tyre
metros	metro-të	hekurudha të nëndheshme
MHz	megahrc-i	njësi e frekuencës barasvlerëse me një milion herc
mica	mikë-a	silikat alkalor që gjendet si mineral në shkëmbenj dhe shërben për izolime elektrike dhe termike
micanite	mikanit-i	material elektroizolues me bazë mikën
micro	mikro	pjesë e parë e fjalëve me kuptimin "i vogël"
micro-abrasion	mikroabrazion	abrazion që nuk shihet me sy
micro-alloyed	i mikrolidhur	që është në përbërje të aliazheve shumë të vegjël
microbial	mikrobial-e	që lidhet me mikrobet
microbiological	mikrobiologjik-e	që lidhet me mikrobiologjinë
microbiology	mikrobiologji	shkencë që studion mikroorganizmat
microclimates	mikroklima-t	tërësi e kushteve dhe regjimeve mikroklimatike
microcopying	1. mikrokopjim; 2. mikrokopjues-e	2) që shërben për mikrokopjim
microelectronic	mikroelektronik-e	që lidhet me mikroelektronikën
microelectronics	mikroelektronikë-a	pjesë e elektronikës që merret me qarqet elektronike në miniaturë
microfiche	mikrofish-i	shirit i mikrofilmit
microfilm	mikrofilm-i	bobinë me filma fotografikë ose vetë shiriti me filmat
microfilming	mikrofilmim-i	filmim i objekteve mikroskopike
microfones	mikrofona-t	aparate që përdoren për regjistrimin e zërit
micro-fungi	mikrokërpudha-t	kërpudha që nuk duken me sy të lirë
micrographic	mikrografik-e	që lidhet me mikrografinë
micrographs	mikrografe-t	grafe që nuk shihen me sy të lirë
microhardness	mikrofortësi-a	fortësi që matet me rrugë mikroskopike
microminiature	mikrominiaturë	miniaturë me përmasa mikroskopike
micro-nutrient	mikroushqyes-i	ushqyes që nuk duket me sy të lirë
micro-organisms	mikroorganizma-t	organizma që nuk duken me sy të lirë
microphone	mikrofon-i	aparaturë për regjistrimin dhe përhapjen e zërit
microphones	mikrofona-t	tërësi mikrofonësh
microprocessor	mikroprocesorë-t	procesorë mikroskopikë
microscope	mikroskop-i	aparaturë për veshtrimin e objekteve të vegjël duke i zmadhuar shumë herë
microscopes	mikroskopë-t	tërësi mikroskopesh
microscopic	mikroskopik-e	me përmasa shumë të vogla që mund të shihet vetëm me mikroskop
microscopical	mikroskopik-e	me përmasa shumë të vogla që mund të shihet vetëm me mikroskop
microsecond	mikrosekundë	njësi e matjes së kohës e barabartë me një të miliontën e sekondës
microstructure	mikrostrukturë	strukturë shumë e imët që shihet vetëm me mikroskop
microvolt	mikrovolt-i	njësi e potencialit elektrik e barabartë me një të miliontën e voltit
microwave	mikrovalë	valë shumë të shkurtra nga 30 deri 1 cm
middle	1. i mesëm; 2. gjysmë	1) që është në mes të dy objekteve; 2) që është bërë deri në gjysmë
middle-distillate	i gjysmëdistiluar	që është destiluar deri në mes të procesit
middleware	gjysmëprodukt	produkt që ka kaluar procesin e përpunimit deri për gjysmë
migration	migrim-i	procesi i kalimit nga njëri vend në tjetrin

mild	provë e butë	provë e kryer në një substrat jo të fortë
military	ushtarak-e	që lidhet me ushtrinë ose me veprime ushtarake
milk	qumësht-i	
milk-based	me bazë qumështi	që ka në bazë të përbërjes qumështin
milking	1. mjelës-e; 2. mjelje-a	1) që shërben për mjelje; 2) proces i marrjes së qumështit nga kafsha
mill	1. mulli-ri; 2. makinë përpunuese	1) makinë që shërben për bluarje; 2) makinë që shërben për përpunimin e një lënde
milling	1. frezues-e; 2. frezim	1) që shërben për frezim; 2) proces i furnizimit me frezë
millivolt	milivolt-i	njësi matëse në elektricitet e barabartë me një të mijtën e voltit
mills	mullinj-të	1) tërësi mullinjsh; 2) tërësi makinash përpunuese
mine	minierë	vend i posaçëm ku nxirren mineralet nga xeherorët
mineral	mineral-i	lëndë joorganike që në përbërje përmban metal ose metale
mineral-filler	mbushës me mineral	pajisje që mbush një hapësirë me mineral
mineralization	mineralizim-i	shndërrim në mineral ose dhënie cilësie minerali
minerals	minerale-t	tërësi mineralesh
miners	kombajna mineralesh	makina të kombinuara që kryejnë në miniera shumë procese pune
miner's	i minavënësit	që i përkasin minavënësit
mines	miniera-t	tërësi minierash
mini	mini	që shpreh konceptin "i vogël"
miniature	miniaturë-a	paraqitje në përmasa shumë të vogla
miniaturized	i miniaturizuar	i paraqitur në përmasa shumë të vogla
mini-couplers	miniçiftëzues-it	çiftëzues me përmasa shumë të vogla
minidisc	minidisk-u	disk në përmasa miniature
minimization	minimizim-i	zvogëlim deri në minimum
Mini-MPO	Mini-MPO	familje e tipit Mini-MPO në fibrat optike
minimum	1. minimum-i; 2. në minimum	1) caku më i ulët; 2) deri në cakun më të ulët
mining	1. për minierë; 2. shpërthim minash	1) që përdoret në minierë; 2) veprim për plasjen e minave
mirror	pasqyrë-a	mjet që pasqyron ose jep imazhin e objektit
mirrors	pasqyra-t	tërësi pasqyrash
miscellaneous	i përzier	që është i përbërë nga lëndë të ndryshme
miscibility	përziershmëri	1) aftësia për t'u përzier; 2) shkalla e përzierjes
mismatch	mospërputhje-a	mungesë përputhjeje ndërmjet objekteve, përmasave, etj.
mist	avull	tym në formë mjegulle nga avujt e ndryshëm
mistake	gabim	shmangie nga e sakta në gjykim, llogaritje, etj.
misuse	keqpërdorim	përdorim jo i drejtë e jo në përputhje me rregullat
mitigation	zbutje-a	proces i paraqitjes ose realizimit në formë të butë
mitre	këndprerje-a	proces i prerjes kryesisht nën një kënd 45 gradë
mitts	doreza-t	veshje duarsh prej materiali të ndryshëm që përdoren për t'i mbrojtur duart
mix	përziemë-a	lëndë e përzier nga lëndë të ndryshme
mixed	i përzier	që është i përbërë nga lëndë të ndryshme
mixer	përzierëse-ja	makinë ose pajisje që shërben për përzierje
mixers	përzierëse-t	tërësi përzierësesh
mixes	përzierje-t	tërësi lëndësh të përziera

mixing	1. përzierës-e; 2. përzierje-ja	1) që shërben për përzierje; 2) proces i shtënies së lëndëve të ndryshme
mixture	përziemë-a	lëndë e përftuar me përzierje
mixtures	përziema-t	lëndë të përfthuara me përzierje
ml	ml (mililitër)	njësi matëse e lëngut sa e njëmijta e litrit
mm	mm (milimetër)	njësi matëse e gjatësisë sa e njëmijta e metrit
mobile	i lëvizshëm	që është i aftë të lëvizë
mobility	lëvizshmëri-a	1) aftësia për të lëvizur; 2) shkalla e lëvizjes
modality	modalitet-i	mënyra ose forma e kryerjes së veprimeve në bazë të rregullave të caktuara
mode	1. formë; 2. tip	1) ana e jashtme; 2) formë e përfaqësimit të një grupi sipas një tipari të caktuar
model	model-i	formë e paraqitjes së një objekti si përfaqësues i tij ose grupi objektiv
modelling	modelim-i	1) krijim i objektit sipas modelit; 2) krijim i modelit
models	modele-t	tërësi e modeleve
moderate	i zbutur	i paraqitur në formë më të butë
modes	1. format; 2. tipa-t	1) tërësi e formave; 2) tërësi e tipave
modifications	modifikimet	tërësi ndryshimesh të pjeshme për të përmirësuar strukturën e cilësisë
modified	i modifikuar	që janë bërë ndryshime të pjeshme për ta përmirësuar
modular	modular-e	që përdor modulën si bazë për konstruktim
modulation	modulim-i	1) varijim karakteristikash; 2) varijim faze, frekuece për transmetim sinjalesh
modulators	modulatorët	pajisje që kryejnë modulimin
module	modul-i	tërësi pjesësh të standardizuara për të ndërtuar një objekt
modules	module-t	tërësi modulesh
moduli	module-t	tërësi modulesh
moduls	module-t	tërësi modulesh
modulus	modul-i	tërësi njësis të standardizuara për të ndërtuar një objekt
moist	1. i lagësht; 2. lagështirë	1) që përmban lagështirë; 2) lëndë e lagët
moisture	lagështirë-a	lëngët e lagët që përmbahet në mjedis
molar	molar-e	që lidhet me gram-molekulat
molecular	molekular-e	që lidhet me molekulat
molecules	molekula-t	grimcat me të vogla të lëndës të përbëra nga atome
molten	i shkrirë	që i është nënshtruar shkrirjes
molybdate	molibdat-i	kripë e acidit molibdik
molybdenum	molibden-i	element kimik metalik i nxjerrë nga molibdenti
molybdosilicate	molibdosilikat-i	përbërje kimike nga molibden dhe silikate
moment	moment-i	1) çast në të cilin realizohet një proces; 2) çasti si madhësi matjeje
monitoring	monitorim-i	kontroll i ecurisë së procesve me anë të monitorit
monitors	monitorë-t	aparaturë sinjalizues e kontrollues i ecurisë së dukurive të caktuara
monoblock	monoblok-u	bllok kompakt
monocalcium	monokalciuri	përbërje kimike vetëm prej kalciumi
monochloride	monoklorid-i	përbërje kimike vetëm prej kloridi
monochrome	monokrom-i	përbërje kimike vetëm prej kromi
monocytogenes	monocitogjene-t	përbërje kimike vetëm prej citogjenesh
monoethylene	monoetilen-i	përbërje kimike vetëm prej etileni



monofilaments	njëfijëse-t	fijeza të përbëra nga një element
monolithic	monolitik-e	që përbëhet nga një bllok i vetëm
monolithic	monolitik-e	që përbëhet nga një bllok i vetëm
monomer	monomer-i	molekulë e thjeshtë që përbën njësinë bazë të një polimeri
monophonic	monofonik-e	për tingujt dhe përbërësit e të njejtit sistem
monopotassium	monokalium-i	përbërje kimike vetëm prej kaliumi
monosulfonate	monosulfonat-i	përbërje kimike vetëm prej sulfonati
monosulfonates	monosulfonate-t	tërësi monosulfonatesh
monoxide	monoksid-i	përbërje binare me një atom oksigjeni të vetëm në molekulën e saj
monozinc	monozink-u	përbërje kimike vetëm prej zinku
mooring	ankorues-e	që shërben për ankorim
moped	çiklomotor-i	1) motoçikletë e vogël; 2) biçikletë me motor
more	më shumë (se)	
morse	Mors	që lidhet me konin Mors për fiksimin e instrumentit prerës
mortar	llaç-i	lëndë për ndërtim me përzierje rërë, gëlqereje dhe uji
mortars	llaçe-t	tërësi llaçesh
motif	motiv-i	shkak që bart një veprim të caktuar
motion	lëvizje	ndryshim i pozicionit të trupit
motor	motor-i	mjet që punon me një lloj energjie e vë në lëvizje mjete të tjera
motor-compressors	motokompresorë-t	agregate të përbërë nga motorë dhe kompresorë
motorcycle	motoçikletë	mjet udhëtimi prej dy ose tre rrotash që punon me motor
motorcyclist	motoçiklist-i	person i specializuar që nget motoçikletën
motor-operated	që punon me motor	
motors	motorë-t	tërësi motorësh
motor-starters	motor-lëshues-it	motorë që ndezin makinën para lëvizjes
mould	formë derdhjeje	formë metalike për derdhje të metalit të shkrirë
moulded	i derdhur në formë	që është derdhur në formë metalike
moulders	formëderdhës-it	pajisje për derdhje në forma metalike
moulding	formues-e	që merr formë në procesin e derdhjes
mouldings	format e derdhjes	pajisje ku formohet metali i derdhur
moulds	format e derdhjes	tërësia e formave të derdhjes
mount	1. montim; 2. ngritje	1) proces i vendosjes në vendin e duhur; 2) proces i ngritjes në lartësi
mountaineering	alpinistike	që lidhet me alpinizmin
mountaineers	alpinistë-t	persona të specializuar e stërvitur për t'u ngjitur në pjesë të vëshira të maleve
mounted	1. i montuar; 2. i ngritur	1) që është montuar; 2) që është ngritur
mounting	1. montues-e; 2. ngritës-e	1) që shërben për montim; 2) që shërben për ngritje
mountings	montatura-t	vend ku është montuar një objekt
mouth	gojë-a	organ i përbërë nga buzët, dhëmbët, gjuha tek qeniet e gjalla
mouthpiece	pipth-i	gypëz për ta mbajtur në gojë
movable	i lëvizshëm	që është i aftë të lëvizë
movement	lëvizje-a	ndryshim pozicionesh në hapësirë
movements	lëvizje-t	ndryshim pozicionesh nga një vend në tjetrin
moving	lëvizës-e	që vë në lëvizje
mowers	motokorrëse-t	makina korrëse të pajisura me motor

mowing	1. korrës-e; 2. korrje-a	1) që shërben për korrje; 2) proces i vjeljes duke e korrur
mulching	mulkues-e	që shërben për ta mbrojtur duke e mbuluar me mulk
multi	shumë-	element përbërës i parë i fjalës për konceptin "shumë"
multi-axial	shumëaksësh-e	që është i përbërë nga shumë akse
multiblade	shumëtheësh-e	që ka shumë tehe prerës
multi-burner	shumëkanelësh-e	që ka shumë kanele djegëse
multi-chamber	shumëdhomësh-e	që përbëhet nga shumë dhoma
multichannel	shumëkanalësh-e	që është i përbërë nga shumë kanale
multicore	shumëzëmërsh-e	që ka shumë zemra
multi-directional	shumëdrejtimësh-e	që lëviz në drejtime të shumta
multi-element	shumëelementësh-e	që përbëhet nga shumë elemente
multi-fibre	shumëfibërsh-e	që përbëhet nga shumë fibra
multifilament	shumëfijëzor-e	që përbëhet nga shumë fijeza
multifocal	shumëfokusor-e	që ka shumë fokuse
multifunction	1. shumëfunktionësh-e; 2. shumëfunktionësi-a	1) që lidhet me shumë funksione; 2) karakteri shumëfunktionësh
multi-function	1. shumëfunktionësh-e; 2. shumëfunktionësi-a	1) që lidhet me shumë funksione; 2) karakteri shumëfunktionësh
multifunctional	shumëfunktionësh-e	që lidhet me shumë funksione
multi-layer	shumështresësh-e	që është i përbërë nga shumë shtresa
multilingual	shumëgjuhësh-e	që lidhet me shumë gjuhë
multilogic	multilogjik-e	që ka shumë arsyetime logjike
multimedia	multimedia	shumë sisteme mjtesh të komunikimit masiv
multimode	shumëformëshe	që ka shumë forma
multi-pair	shumëçiftësh-e	1) që përbëhet nga shumë çifte; 2) përbërje me shumë çifte
multiple	i shumëfishtë	që ka shumë elemente
multiple-beam	shumëfishrrezor-e	që është i përbërë nga rreze shumëfishe
multiplex	multipleks-e	që përbëhet nga shumë elemente komplekse
multiplexed	i pleksëzuar	i përbërë nga shumë elemente komplekse
multiplexing	pleksëzues-e	që e përbën me shumë elemente komplekse
multiplication	1. shumëzim; 2. shumëfishim	1) kryerje e veprimit të shumëzimit; 2) shtim në numër ose sasi
multiply	1. shumëzoi; 2. shumëfishoj	1) kryej veprimin e shumëzimit; 2) shtoj në numër ose sasi
multi-point	shumëpikësor-e	që bëhet në shumë pika
multi-pole	shumëpolësh-e	që ka shumë pole
multi-protocol	shumëprotokollësh-e	që bëhet në bazë të shumë protokolleve
multi-purpose	shumëqëllimësh-e	që ka shumë qëllime
multi-purpose-test	provëshumëqëllimëshe	provë që realizon qëllime të shumta
multi-rate	shumëraportësh-e	që është e lidhur me shumë raporte
multi-residue	shumëmbeturinësh-e	që lidhet me krijimin e shumë mbeturinave
multi-series	shumëserijësh-e	që përbëhet nga shumë seri
multi-spindle	shumëshpindëlsh-e	që përbëhet nga shumë shpindela
multi-spot	shumëpikësor-e	që saldohet në shumë pika të caktuara
multi-state	shumëgjendjesh-e	që karakterizohet nga shumë gjendje
multi-track	shumëpistësh-e	që ka shumë pista në shiritin e vet
multi-turn	shumëspirësh-e	që përbëhet nga shumë spira

muscle	muskul	tërësi indesh të shtrirshme të trupit që realizojnë lëvizjet e tij
music	muzikë	1) arti i tingujve dhe instrumenteve; 2) prodhim muzikor
mussels	midhje-t	butakë guackorë me dy kapakë me mish brenda që përdoret për ushqim
muting	shurdhues-e	1) që shërben për të krijuar tinguj shurdhues
nailed	i gozhduar	që është i bashkuar me gozhdë
nailing	1. gozhdues-e; 2. gozhdim-i	1) që shërben për gozhdim; 2) proces i bashkimit me gozhdë
nails	gozhdë-t	tërësi gozhdësh
named	i emërtuar	që i është vënë emërtimi
names	emërtime-t	emra që u vihen objekteve
naming	emërtues-e	që shërben për emërtim
nanohenry	nanohenri	njësi matëse e barabartë me një të miliardën e henrit
naringin	naringin	lëndë e lëngshme në agrume
narrow	i ngushtë	me gjerësi të vogël
narrow-band	1. brez i ngushtë; 2. brezngushtë	1) brez me gjerësi të vogël; 2) që ka brez të ngushtë
national	kombëtar-e	që lidhet me kombin
native	natyror-e	që lidhet me natyrën
natural	natyror-e	që lidhet me natyrën
navigation	lundrim-i	qarkullimi i mjeteve lundruese
navigator	lundrues-i	që shërben për lundrim
near-infrared	afërinfrakuq-e	që është afër vetive të rrezeve infrakuqe
nebulizing	1. mjegullzues-e; 2. mjegullzim-i	1) që spërkat në formë mjegulle; 2) spërkatje në formë mjegulle
necessary	i nevojshëm	që është i përshtatshëm për nevoja të caktuara
neck	qafë	kanal rrethor i ngushtë i një detali
needle	gjilpërë	detal i hollë i gjatë me majë
needled	me gjilpëra	që është pajisur me gjilpëra
needle-flame	flakë gjilpëre	flakë që del me trysni në formë gjilpëre
needles	gjilpëra-t	tërësi gjilpërash
needs	nevoja-t	kërkesa të domosdoshme për t'u realizuar
negative	negativ-e	që është i kundërt me vlerën ose anën pozitive
negotiation	marrëveshje-a	diskutim për të vendosur për një zgjidhje
neon-transformers	neon-transformatorë-t	transformatorë për rrjetin e dritave me neon
nerve	nerv-i	fijëz ose tërësi fijëzash që bartin impulset e ndijimit
net	1. rrjetë-a; 2. rrjet-i	strukturë me elemente përbërëse
nets	rrjete-t	tërësi rrjetësh
netting	1. rrjetëzues-e; 2. rrjetëzim-i	1) që krijojnë një rrjetë; 2) krijim i një rrjete
network	1. rrjetë-a; 2. rrjet-i	2) tërësi lidhjesh të ndërthurura
networking	1. rrjetëzues-e; 2. rrjetëzim-i	1) që krijojnë rrjet; 2) krijim i një rrjeta
networks	1. rrjete-t; 2. rrjeta-t	1) tërësi e rrjeteve; 2) tërësi e rrjetave
neuro-otological	neuro-otologjik-e	që lidhet me nervat dhe veshin
neutral	asnjëanës-e	1) që s'ka ngarkesë negative ose pozitive; 2) që nuk krijon reaksion
neutralizing	asnjëanësues-e	që shërben për asnjëanëzim
new	i ri	1) që nuk ka ekzistuar më parë; 2) i shfaqur rishtas

newspapers	gazeta-t	botim i përditshëm me disa fletë
nibblers	makina kruajtëse	makina për kruajtjen e sipërfaqes
NICAM	NICAM - sistem zanor dixhital dykanalësh	ton shumëkanalësh sipas mënyrës NICAM - sistem zanor (toni) dixhital dykanalësh
nickel	nikel-i	element kimik metalik që përdoret në lidhje, për monedha, etj.
nickelbase	1.me bazë nikeli; 2.bazë nikeli	që ka në bazë të përbërjes nikelin
nickel-based	me bazë nikeli	që ka në bazë të përbërjes nikelin
nickel-cadmium	nikel-kadmium	
nickel-metal	nikel-metal	me përbërje nikelin dhe një metal tjetër
Ni-Cr	Ni-Cr (nikel-krom)	
niobium	niobium-i	
nipples	nipela-t	bashkues tubash në formë qafosh
nitrate	nitrat-i	1.kripë e acidit nitrik; 2.pleh azotik ose nitrat amoni
nitrates	nitrate-t	
nitric	nitrik-e	që ka në përbërje azot
nitride	nitrid-i	
nitriding	1.nitridëzues-e; 2.nitidëzim-i	1.që shërben për nitridëzim; 2.proces i shndërrimit në nitrid
nitrification	nitritizim-i	proces i shndërrimit në nitrit
nitrite	nitrit-i	nitrat kaliumi në gjendje natyrore
nitrogen	azot-i	element kimik jometalik gazor , përbërës kryesor i ajrit
nitrophenols	nitrofenole-t	
nitrox	nitroks-i (gaz nitroksi)	aparartet e mbrojtjes së frymëmarrjes, rubinetate e bombolave të gazit, rakordet e daljes së gazit nitroks
N-methyl	N-metil-i	
NN-diethyl-14-phenylenediamine	NN-dietil-14-fenilendiamin-i	
N-Nitrosamines	N-nitrosamine-t	
N-Nitrosatable	(i,e) N-nitrosueshëm	metodat e përcaktimi i çlirimit të lëndëve N-nitrosamine dhe të N-nitrosueshme nga biberonët dhe shishet
noble	1.fisnik-e ; 2.(i,e) çmueshëm	që vlerësohet i çmueshëm, si ari, argjendi
node	nyjë-a	
nodes	nyja-t	
noise	zhurmë	tingull i çrregullt i përzier e jo i qartë
no-load	pa ngarkesë	që nuk është i ngarkuar
nomenclature	nomenklaturë	tërësi emërtimelesh në një listë
nomenclatures	nomenklatura-t	
nominal	nominal-e	që lidhet me emërtimin e jo me vlerën reale
non	jo-	që shënon atë që mungon
non-accessible	joaksesibël-e	1.i pafutshëm në të ; 2.i pa arritshëm në kufijtë e tij
non-acid	joacidik-e	që nuk është acid
non-acoustic	joakustik-e	që nuk lidhet me akustikën ose proceset akustike
non-active	joaktiv-e	që nuk është aktiv
non-agricultural	jobujqësor-e	që nuk lidhet me bujqësinë
non-alloy	joaliazh-i	lëndë kimike që nuk përbën lidhje metalike
non-alloyed	i paleguar	që nuk është i lidhur me me elemente të ndryshme
non-angled	jokëndor-e	1.që nuk ka kënd ; 2.që nuk është në kënd
non-aqueous	joujor-e	1.që nuk lidhet me ujën ; që nuk ka ujë

non-automatic	joautomatik-e	që nuk kryen procese automatike
non-biological	jobiologjik-e	1.që nuk lidhet me biologjinë ; që nuk është biologjik
non-broadcast	jordiateleviziv-e	që nuk lidhet me proceset radiotelevizive
non-cellular	joqelizor-e	1.që nuk lidhet me qelizën; që nuk është qelizor
non-cellulosic	jocelulozik-e	që nuk është celulozik
non-combustibility	padjegshmëri-a	aftësia për të mos u djegur
non-conductive	jopërcjellës-e	që nuk ka aftësinë për të përcjellë
non-conductivity	papërcjellshmëri-a	aftësia për të mos përcjellë
nonconformance	pakonformancë-a	1.gjendje pa konformancë; 2.pa mundësi për të patur konformancë
non-connectorised	i papajisur me bashkues	
non-copper	1.pa bakër; 2.jo bakër	1.që nuk ka bakërgjendje pa konformancë; 2.përbërje pa përmbajtje bakri
non-creped	(i,e) parrudhosur, (i pazhubrosur)	që nuk ka rrudha në përbërje (nuk është i zhubrosur)
non-cylinder	1.jo cilindër-i; 2.jocilindrik-e	1.strukturë që nuk ka formë cilindri ; 2.që nuk është cilindër
non-dangerous	i parrezikshëm	që nuk paraqet rrezik
non-destructive	joshkatërrues-e	që nuk është i aftë të shkatërrojë
non-domestic	jo shtëpiak-e	që nuk lidhet me shtëpinë apo me kushtet shtëpiake
non-electric	joelektrik-e	që nuk lidhet me elektricitetin
non-electrical	joelektrik-e	që nuk lidhet me elektricitetin
non-electrolytically	joelektrilikisht	jo në mënyrë (rrugë) elektrolitike
non-end-load-bearing	pa përmbajtje ngarkese fundore	që nuk mban ngarkesë fundore
non-eugenol	joeugenol-i	1.përbërje joeugenole; 2.pa përmbajtje eugenoli
non-fat	pa dhjamë	që nuk ka përmbajtje dhjami
non-fatty	i pa dhjamur	që nuk është i dhjamur
non-ferrous	johekuror-e	1.që nuk ka në bazë të përbërjes hekur; 2.që është me ngjyra
non-filtration	pa filtrim	që nuk kryhet procesi i filtrimit
non-fire	1.pa flakë; 2.i pa djegshëm	1.që nuk jep flakë; 2.që nuk mund të digjet
non-fire-resistant	jorezistues ndaj flakës	që nuk i reziston flakës
non-flammable	i pandezshëm	që është i paaftë të ndizet (digjet)
non-fluxed	i paflusuar	që nuk ka fluse në përbërje
non-gas-tight	jo gazdepërtues-e	që mund të depërtojnë gazet në të
non-hardening	jofortësues-e	që nuk është i aftë të fortësojë sipërfaqen
non-heat-dissipating	jo përhapës i nxehtësisë	që nuk është i aftë të përhapë nxehtësinë
non-hydrolyzable	i hidrolizueshëm	i paaftë për t'u hidroizoluar
non-impregnated	i pandërngopur	që nuk është ngopur plotësisht
non-industrial	joindustrial-e	që nuk përdoret në industri
non-instrumented	i papajisur me insrumente	
non-interactive	jondërvepruese-e	që është i paaftë të veprojë me elemente të tjera
non-invasive	i pashpërthyeshëm	i paaftë të shfaqet me shpërthim
nonionic	jojonik-e	që s'ka jone në përbërjen e vet
non-ionic	jojonik-e	që s'ka jone në përbërjen e vet
non-keyboard	pa tastierë	që nuk është i pajisur me tastierë

non-linear	jolinear-e	që nuk është në vijë të drejtë
non-loadbearing	jongarkesëbartës-e	që nuk bart ngarkesë nga një vend në tjetrin
non-magnetic	jomagnetik-e	që nuk ka veçori magnetike
non-metallic	jometalik-e	1.që nuk është i përbërë prej metali ; 2.që nuk ka metal
non-motor	pa motor	1.që nuk punon me motor ; 2.pa motor
non-optical	jooptik-e	1.që nuk lidhet me optikën ; 2.që nuk ka veçori optike
non-organic	joorganik-e	1.që nuk ka lëndë organike; 2.që nuk është organik
non-oriented	i paorientuar	që nuk orientim të caktuar
non-oxides	pa okside	që nuk ka në përbërje okside
non-parallelism	joparalelesi-a	veçoria për të moë qenë paralele
non-pharmaceutical	jofarmaceutik-e	1.që nuk ka karakter farmaceutik; 2.që nuk lidhet me farmaceutikën
non-phosphate	1.jofosfat-i; 2.pa fosfat	1.lëndë që s'ka fosfat; 2.që nuk ka fosfat në përbërje
non-porous	joporoz-e	që nuk është me pore
non-powered	joplukuror-e	1. që nuk është i natyrës pluhurore; 2.që nuk ka pluhur
non-pressure	pa tryzni	që nuk gjendet nën tryzni
non-pressurised	pa tryzni	që nuk është ushtruar tryznia mbi të
non-professional	joprofesional-e	1.që nuk ka karakter profesional; 2.që nuk lidhet me një profesion të caktuar
non-protein	pa proteina	që nuk ka në përbërje proteina
non-reclosable	i parimbyllshëm	që nuk mund të mbyllet sërish
non-refillable	i parimbushshëm	që nuk mund të mbushet sërish
non-removable	i pazhvendosshëm	që nuk ka aftësinë (mundësinë) për t'u zhvendosur
non-return	1.i pakthyeshëm; 2.moskthim	1.që nuk ka aftësinë (mundësinë) për tu kthyer ; 2.pamundësia për t'u kthyer
non-returnable	i pakthyeshëm	që nuk ka mundësi të kthehet
non-rinsed	i pashpëlarë	që nuk është bërë procesi i shpëlarjes
non-rotary	jorrotullues-e	që nuk rrotullohet
non-round	jo i rrumbullakët	që nuk ka formë të rrumbullakët
non-sailing	jolundrues-e	që nuk ka vetinë të lundrojë
non-self-healing	jovetëregjenerues-e	e paaftë të regjenerojë vetë
non-solid	jo i ngurtë	jo në gjendje të ngurtë
non-specified	i paspecifikuar	që nuk është i specifikuar
non-standardized	i pastandardizuar	që nuk i është bërë standardizimi
non-stationary	1.jostacionar ; 2.i pafiksuar	që nuk është në një vend të fiksuar
non-structural	jostrukture	që nuk ka strukturë të caktuar
non-task-related	i palidhur me detyrën	që nuk lidhet me detyrën
non-telecommunication	jotelendërlidhje-a	që nuk lidhet me telendërlidhjen
non-threaded	i pafiletuar	që është pa fileto
non-uniformity	jonjëtrajtësi-a	moskarakterizim nga qënia e njëtrajtëshme
non-ventilated	i paventiluar	që nuk ka sistem ventilimi
non-volatile	jofluror-e	që nuk është i aftë të shpëputet nga lënda e të përhapet në ajër
non-wavelength-selective	jopërzgjedhës i gjatësisë së valës	që nuk përzgjedh gjatësinë e valës
non-wirable	i palidhur	që nuk është i lidhur me tel
non-wire	pa tel	që nuk lidhet me tel

non-wirewound	i pambështjellë me tel	që nuk ka mbështjellje teli
nonwoven	i pathurur	me elementë të palidhur me thurje
non-woven	i pathurur	
non-woven/woven	i pathurur /i thurur	që është i lidhur pa thurje dhe me thurje
nonwovens	pjesë të pathurura	pjesë për provë që nuk kanë thurje
nordic	nordik-e	që ka të bëjë me provën e quajtur nordik (skandinav)
normal	normal-e	që nuk është në gjendje normale
normalized	i normalizuar	që i është nënshtruar normalizimit
normative	normativ-e	që lidhet me normativat e caktuara
notations	sistem shenjor	sistem shenjash që paraqitin në mënyrë të simbolizuar një informacion
notch	çallatë/a	pjesë e prerë e ngritur në formë dhëmbi
notched	1. Kanal; 2. i çallatizuar	që është i përbërë nga një seri dhëmbëzash
note	shënim	
notes	shënime-t	
not-fat	jo me dhjamë	që nuk ka dhjamë në përbërje
notice	1/vërejtje-a; 2.shënim-i	nxjerrje në pah e një veçorie
notice applies	vërejtje për përdorim	
nozzle	dizë	pjesë si hundëz që nxjerr fluidin me trysni si curril
nozzles	diza-t	tërësi dizash
nuclear	bërthamor-e	që ka në bazë ndërtimi bërthamën
number	numër-i	
numbering	numërtim-i	shënim me numër
numbers	numra-t	
numeral	numëror-i	
numerals	numërorë-t	
numeric	numerik-e	që lidhet me sistemin e numërave
numerical	numerik-e	që lidhet me sistemin e numërave
numerically	numerikisht	1.nga ana numerike; 2.në mënyrë numerike
nursing	1.përkujdesje mjekësore ; 2.ushqyerje me gji	
nut	dado-ja	detal bashkues bulonash me faqe dhe me vrimë të filetuar
nutation	rrotullim bosh	
nutrient	ushqyes-i	element ushqyes
nutrients	ushqyes-it	
nuts	dado-t	
oak	lis-i	dru pylli i lartë me fryte lende, që përdoret në ndërtim etj.
object	objekt-i	
objective	1.objektiv-i ; 2.objektiv-e	
objects	objekte-t	
observe	vrojtoj	ndjek duke vëzhguar
obtained	i përftuar	i nxjerrë me anë të përpunimit
obtaining	1. që përfton; 2) përftim	1) që nxjerr me anë të përpunimit
obturating	1. taposës-e; 2. taposje	1) që zë një vrimë në mënyrë hermetike

occupational	profesional-e	që lidhet me një profesion të caktuar
ochratoxin	okratoksinë	
octave-band	bandë tetëshe	bandë me shkallë përcaktimi tetë pikëshe
ocular	1. okular-e; 2. okular-i	
odorants	lëndë kundërmuese	lëndë që lëshojnë erë të mirë
odour	aromë	erë e këndshme
off-board	larg nga trupi	që bëhet jo në vetë objektin, por larg tij
off-flavour	larg aromës	që bëhet larg kufirit ku ndjehet aroma
off-gas	jashtë gazit	që bëhet larg gazit, jo në të
offgassing	zhgazues-e	që shërben për heqjen e gazit
office	zyrë	vend ku kryhet një veprimtari zyrtare
offset	zhvendosje (faze)	lëvizje nga njëra pikë në tjetrën
offshore	në det të hapur	
ohm	om-i	njësi matëse e rezistencës elektrike
ohmic	omik-e	që ka të bëjë me omin si njësi matëse
ohmmeters	ommetra-t	matësa të rezistencës elektrike
ohms	ome-t	
oil	vaj	lëng yndyror bimor ose shtazor
oil-filled	i mbushur me vaj	
oilhardened	i fortësuar në vaj	që i është bërë fortësimi me zhytje në vaj
oil-immersed	i zhytur në vaj	që është përpunuar me zhytje në vaj
oil-impregnated	i ndërngopur në vaj	që është ngopur me vaj deri në brendësi
oils	vajra-t	
oilseed	farë vajore	farë nga e cila prodhohet vaj
oilseeds	fara vajore	
oily	vajore	
olive	ulli-ri	dru me gjelbërim të përjetshëm që prodhon fryte për vaj
olivine	olivinë-a	silikat hekuri e magnezi
omega	omegë	shkronjë e fundit e alfabetit grek
on	në	parafjalë me një ndër kuptimet "në sipërfaqe të objektit"
on-board	1. në trup; 2. në bord	1) që bëhet në trup të objektit
on-demand	i kërkuar	që bëhet sipas kërkesës ose nevojës
one	një-	që ka në përbërje një element
one-coat	me një veshje	që ka një veshje
one-component	njëpërbërës-e	që ka si element një përbërës të vetëm
one-mark	njëmarkësh-e	që ka një markë
one-piece	njëcopësh-e	që është i përbërë nga një copë pa pjesë të tjera
one-point-cut	njëmajësh-e	që ka një majë
one-third-length	një e treta e gjatësisë	
one-third-octave	një e treta e oktavës	
on-line	në linjë	që është në linjë të drejtpërdrejtë të pandërprerë
on-load	në ngarkesë	që ndodhet i ngarkuar
only	vetëm	
onshore	në breg	në kufijtë e bregut të detit
on-site	në vend	në vendin ku ka ndodhjen e vet dhe ku vepron
opacity	opakësi-a	mungesë tejdukshmërie
opaque	opak-e	që është i patejdukshëm
open	i hapur	
open-circuit	qark i hapur	
opening	1. hapës-e; 2. hapje	1) që shërben për hapje; 2) proces i hapjes; 3) vend i hapur



openings	çeltina-t	vende të hapura me hapësira të lira për të ndërtuar e kaluar një objekt
open-top	grykëhapur	me grykë të pambyllur për t'u mbrojtur periodikisht
operability	1. përdorshmëri; 2. shërbyeshmëri	1) aftësia për t'u përdorur; 2) aftësia për të shërbyer
operated	1. i përdorur; 2. i vënë në punë	
operating	që punon	
operation	1. veprim; 2. operacion; 3. shërbim	
operational	operacional-e	
operations	operacione-t	
operator	operator-i	person i specializuar që drejton një aparaturë, makinë, etj.
operator-powered	i vënë në punë nga operatori	
operators	operatorë-t	
operator's	i operatorit	
ophthalmic	oftalmik-e	që lidhet me okulistikën
ophthalmology	oftalmologji	pjesë e mjekësisë që studion aparatin pamor
ophthalmometers	oftalmometra-t	instrumente për matjen e lakores korneale
ophthalmoscopes	oftalmoskopë-t	instrumente që ekzaminojnë retinën dhe funksionet e syrit
opportunity-charging	me ngarkim të mundshëm	
ophthalmic	oftalmik-e	që lidhet me okulistikën
optic	optik-e	që lidhet me optikën
optical	optik-e	që lidhet me optikën
optical-density	dendësi optike	
optically	optikisht	1) në mënyrë optike; 2) nga ana optike
optics	optikë-a	1) shkencë që studion dukuritë optike; 2) teknika e instrumenteve optike
optimal	optimal-e	që është në kushtet më të përshtatshme
optimized	i optimizuar	që i janë krijuar kushtet më të përshtatshme
optimum	optimum	kusht më i përshtatshëm
opto-electronic	opto-elektronik	që lidhet me kontrollin elektronik të shikimit
optotype	optotip-i	kuadër i ndriçuar me shkronja për kontrollin e shikimit
optotypes	optotipa-t	
oral	gojor-e	që lidhet me gojën
orbital	orbital-e	që lidhet me vijën orbitale
order	rend-i	
ordering	1. renditës-e; 2. renditje	që rendit sipas një rregulli
ordinary	i zakonshëm	që është i rendit të rëndomtë
organic	organik-e	
organically	organikisht	në mënyrë organike
organism	organizëm	
organisms	organizma-t	
organization	organizim-i	mënyrë e vënies rregull (në punë)
organochloride	organoklorid-i	
organochlorine	organoklorinë-a	
organophosphorus	organofosfor-i	

orientation	orientim-i	
oriented	i orientuar	
origin	origjinë	
original	1. original-i; 2. original-e	
originals	originale-t	
O-ring	unazë-O	detal unazor në formë O
O-rings	unaza-t-O	
oropharyngeal	orofaringal-e	që lidhet me raportet e organeve të gojës dhe të faringut
orthogonal	ortogonal-e	që formon kënd të drejtë me një element tjetër
orthographic	ortografik-e	që lidhet me shkrimin e drejtë dhe korrekt
orthophosphate	ortofosfate-t	
orthoses	orteza-t	pjesë të protezës që shërbejnë për drejtim
orthotropic	ortotropik-e	që ka aks pak a shumë vertikal
oscillating	lëkundës-e	1. që krijon lëkundje; 2. që lëkundet
oscillation	lëkundje	
oscillation-type	tip lëkundës	tip që krijon lëkundje
oscillators	lëkundës-it	aparate që lëkunden
oscillatory	lëkundës-e	që lëkundet
osteosynthesis	osteosintezë-a	sintezë që lidhet me aparatin skeletor
ostomy	ostomi-a	qese mbledhëse për ostomi
other	tjetër	
out	jashtë	
outboard	jashtë bordi	
outdoor	1. jashtë; 2. i jashtëm	që kryhet në mjedis të jashtëm dhe jo brenda
outdoors	1. jashtë; 2. i jashtëm	që kryhet në mjedis të jashtëm dhe jo brenda
outer	i jashtëm	që kryhet jashtë
outgassing	shgazim-i (çgazim-i, degazimi)	prova e shgazimit në vakum termik për përzgjedhjen e materialeve të një projekti special
outgoing	1. dalës-e; 2. i shfrytëzuar	1. që shërben për dalje; 2. që është përdorur ose konsumuar
outlet	vrinëdalje	hapësirë në formë vrime për zbrazje
outlets	vrinëdalje-t	
outline	kontur-i	vijë që paraqet formën e jashtme të objektit, imazhit
outlines	konture-t	
out-of-band	1. jashtë diapazoni; 2. jashtë brezit	
out-of-plane	jashtërrafshor-e	
output	dalje	të dhënat e përpunuara që dalin në një sistem përpunimi
outputs	daljet	
outside	jashtë	
outsoles	shoje të poshtme	
out-through	këputje (dinamike)	prerje e kabllit aeronautik
oven	furrë	pajisje me vatër të posaçme për tharje
oven-drying	që than në furrë	
ovens	furra-t	
ovenware	enë zjarrduruese	enë që i reziston temperaturave të larta
over	mbi	që qëndron sipër nivelit të objektit
overall	tërësor-e	që përfshin tërësisht procesin ose objektin ku kryhet procesi
overcoated	i mbiveshur	që mbulon nga sipër objektin
overcurrent	mbirrymë	rrymë që tejkalon forcën e rrjedhjes së saj

overground	mbitokësor-e	që ndodhet ose kryhet mbi sipërfaqen e tokës
overhead	ajror-e	që është vendosur (kalon) në pozicion varur mbi objekt
overlay	mbulesë	shtresë që mbulon objektin
overload	mbingarkesë	ngarkesë që tejkalon masën e zakonshme
over-needle	mbigjilpëror-e	që ndodhet mbi nivelin e gjilpërës
over-rim	shkarkim	proces zbrazeje nga sipër
overview	1. pamje e përgjithshme; 2. paraqitje	paraqitje në plan e pjesëve të përgjithshme
overvoltage	mbitension	tension mbi masën e caktuar
overvoltages	mbitensione-t	
own	i vet	që i përket vetvetes
owner	posedues-i	subjekt që zotëron objektin e dhënë
owner's	(i,e) poseduesit	që i përket poseduesit
oxalate	oksalat-i	kripë ose ester i acidit oksalik
oxidation	oksidim-i	reaksion kimik i kombinimit të një lënde me oksigjenin
oxidative	oksidues-e	që kryhen oksidimin
oxide	oksid-i	kombinim i një metali me oksigjenin
oxide/eugenol	eugenol oksid	
oxides	okside-t	lidhja e një elementi kimik me oksigjenin
oxidized	i oksiduar	që i është nënshtruar oksidimit
oxidizing	oksidues-e	që krijon okside
oximeters	oksimetra-t	aparate për matjen e pulsit të pacientit
oxyfuel	oksikarburant-i	
oxygen	oksigjen	
oxygen/fuel	karburant oksigjenor	lëndë djegëse oksigjenore
oxygenate	oksigjenat-i	
oxygen-nitrogen	oksigjen-azot	me përbërje oksigjen dhe azot
ozone	ozon-i	formë alotropike e oksigjenit e prodhuar në atmosferë nga shkarkimet elektrike
pacemakers	pejsmejkera-t	aparate elektronik i vogël për mbajtjen konstant të pulsimit kardiak
package	paketë	mbështjellëse prej lëndësh të ndryshme
packaged	i paketuar	i mbështjellë me mbulesa lëndësh të ndryshme
packages	paketa-t	
packaging	paketues-e	që shërben për paketim
packers	paketuesi-t	persona që kryejnë paketimin
packing	1. paketues-e; 2. paketim	që shërben për paketim
packs	paketa-t	
pad	1. pllakë (bravë); 2. mbajtëse (çelësash)	
padlock	bravë	
padlocks	brava-t	pajisje e thjeshtë për mbajtjen e bravës
pads	1. copa të derdhura; 2. jastëkë-t; 3. pllakat	
paediatric	pediatrik-e	që lidhet me pediatriinë
page	faqe-ja	sipërfaqe anësore e një objekti
pages	faqe-t	
paint	bojë-a	lëndë e lëngët që shërben për të lyer
painting	bojatisës-e	që shërben për të lyerje me bojë

paints	bojëra-t	
pair	çift-i	dy elemente të lidhura si pjesë e një të tëre
pair/quad	çift kuadratik	
pairs	çifte-t	
PAL	PAL (sistemi PAL i përhepjes televizive)	sistemi i videodisqeve optikë reflektues të pararegjistruar "Lazer vizion" 50 Hz / 625 linja-PAL
palladium	paladium-i	
pallet	paletë	platformë për mbajtje ngarkesash të transportueshme
palletisers	paletizues-it	pajisje për përgatitjen e paletave dhe manovrimin me to
pallets	paleta-t	
pan	1. koritë; 2. kuvetë	1. pjesë në formë lugu; 2. pjesë e VC-së në formë poçi
panel	panel-i	copë dërrase në formë shiriti për veshje etj
panelling	panelveshës-e	që shërben për veshje me panele
panels	panele-t	
panic	panik-u	
pans	1. korita-t; 2. kuveta-t	
panthographs	pantografë-t	
pantograph	pantograf-i	pajisje që kalon rrymën nga teli i varur tek trani
paper	letër	lëndë në formë flete të hollë e prodhuar nga druri
papers	letra-t	
parachutes	parashuta-t	pajisje në formë ombrelle për t'u hedhur nga aeroplani
paraffin	parafinë	
paragliders	planerues-it	mjete fluturuese të lehtë që fluturojnë me rrëshqitje
paragliding	planerim-i	fluturim me rrëshqitje
parallel	1. paralel; 2. paralel-e	1. vijë paralele me një tjetër; 2. që është paralel me një tjetër
paramagnetic	paramagnetik-e	që orienton dipolet në kahun e fushës magnetike
parameter	parametër-i	karakteristikë e matshme
parameters	parametra-t	
parametric	parametrik-e	që lidhet me parametra të caktuar
parametrized	i parametrizuar	që është futur në sistemin e parametrave të caktuar
parathion	paration-i	përbërje organofosforike në ujë
parathion-methyl	paration-metil	përbërje parationi dhe metili
parenteral	jashtintestinal	që gjëndet ose ndodh jashtë zorrës
parking	1. parkues-e; 2. parkim; 3. vendparkim-i	1. që shërben për parkim; 2. veprim i parkimit; 3. vend për parkim
parquet	parket-i	shtrojë dyshemeje prej panelesh dërrase
part	pjesë	
partial	i pjesshëm	që përbën një pjesë
partially	pjesërisht	në mënyrë të pjesshme
particle	grimcë	pjesëz shumë e imët e lëndës
particleboards	panele me përbërje grimcore	
particles	grimca-t	
particular	i veçantë	që ka veçori karakteristike për të
particularly	në mënyrë të veçantë	
particulate	grimcë-a	pjesës shumë e vogël e një lënde
partie	1. pjesë-a; 2.sektor-i	
parties	1. pjesë-t; 2. sektorë-t	

partitions	ndarëse-t	struktura që ndajmë një pjesë nga një tjetër
partly	pjesërisht	në mënyrë të pjesëshme
parts	pjesë-t	
part-turn	rrotullim fragmentar	rrotullimi me fragmente, rrotullim inkremental (i pjesëshëm)
passage	kalim	hapësirë ose rrugë nëpër të cilën kalohet
pass-by	anashkalesë-a	rrugë e veçantë që kalon anash një rruge kryesore
passenger	udhëtar-i	person që udhëton me mjet transporti
passengers	udhëtarë-t	
passivated	i pasivizuar	që i janë dhënë veti pasive
passivation	pasivizim-i	proces i dhënies së vetive pasive
passive	pasiv-e	
passwords	fjalëkalim-i (pasuord)	tërësi fjalësh të koduara për të hyrë në një mjet përpunimi informacioni
pasta	1. brumë; 2. makarona	1. përzjerje e trashë mielli dhe uji
paste	brumë makaronash	
pastes	brumëra makaronash	
pastry	pastë	
patch	boshllëk-u (vend me defekt)	vend i pambushur në rrugë si njollë difektoze
patent	llak-u	lloj boje për të lyer sipërfaqen për ta mbrojtur dhe dhënë shkëlqim
patented	i patentuar	i përpunuar me zhytje në banjë
path	rrugë	kalim për lëvizje
paths	rrugë-t	
patient	pacient-i	person që merr trajtim mjekësor të caktuar
patients	pacientë-t	
pattern	1. model-i; 2. diagramë	objekt që shërben si bazë për të prodhuar një tjetër sipas tij
patterned	i stampuar	që i është nënshtruar stampimit
patterns	modele-t	
pavement	1. trotuar; 2. kalldrëm	
paver-finishers	shtruese-përmbaruese-t	makina që bëjnë punime shtrimi dhe përmbarimi të rrugëve
pavers	kalldrëme-t	rrugë të shtruara me gurë
paving	shtrim-i	proces i veshjes me kalldrëm
pay	pagesë	
payload	ngarkesë e dobishme	ngarkesë që kryhen punë
payment	pagesë	
payphone	telefon me monedhë	shërbim telefonik me futje monedhe në aparatin telefonik
PC	ÇP (çimento Portland)	lloj çimentoje e tipit Portland për lidhje me panelet prej druri
PCB	BPK (bifenil i poliklorinuar)	grup përbërjesh nga lidhje të atomeve klorine me molekula të bifenilit
peak	pik-u	caku më i lartë i një procesi
pedal	pedal-i	këmbëz që shkelet me këmbë për të kryer lëvizjen
pedals	pedale-t	
pedestal	1. për këmbët; 2. mbështetëse këmbësh	për vendosjen e këmbëve

pedestrian	1. për këmbët; 2. me këmbë	1. për vendosje këmbësh; 2. që komandohet me anë të këmbës
peel	lëkurë (ngjyrë lëkure)	ngjyra që ka lëkura për të provuar vetinë ngjitëse në metal
peeling	ngjyrë lëkure	prova e ngjyrës së lëkurës
peening	rrahje me çekiç	
pegboard	panel me kunj	dërrasë për procesin e lidhjes me kunj
pelletisers	peletizuese-t	makina për prodhim paletash
pelton	Pelton	lloj turbine e tipit Pelton
pencil	kalem-i	instrument në formë lapsi për të provuar fortësinë
pendulum	lavjerrës-i	trup i varur që kryen lëvizje lëkundëse
penetrant	depërtues-e	që depërton në brendësi të objektit ose mjedisit
penetration	depërtim	proces i kalimit të fluidit në pjesët e pahermetizuara
pen-injectors	maja injektuese	injektorë me maja në formë pene
people	personat	njerëz që kryejnë veprimtari të caktuara
per	për	parafjalë me kuptimin "në çdo"
percentage	përqindje	
perceptible	i perceptueshëm	që është i mundshëm të kapet nga organet e shqisave
perchloric	perklorik-e	i acidit klorik me gradë më të madhe oksidimi
perchloroethylene	perkloroetilen-i	përbërje perkloruri dhe etileni
percussive	goditës-e	që shërben për goditje
perforated	i birëzuar	që i janë hapur vrima në të
perforation	birëzim-i	proces i hapjes së vrimave
perforator	birëzues-i	pajisje për hapje vrimash
performance	1. ekzekutim-i; 2. realizim-i; 3. funksionim	1.2. vënie në përdorim; 3. mënyra se si funksionon rregullisht
performances	1. realizimet 2. funksionimet	
performed	1. i ekzekutuar; 2. i realizuar; 3. që funksionon	1.2. i vënë në përdorim; 3. që vë në funksionim
performing	1. ekzekutues-e; 2. realizues-e; 3. funksionues-e	1.2. që vë në përdorim; 3. Që vë në funksionim
perfringens	perfringense-t	lëndë në produktet ushqimore që provohen <i>Clastridium perfringens</i>
perimeters	perimetra-t	
period	1. periodë; 2. periudhë	1. kohë në të cilën një madhësi kryen një cikël të plotë; 2. hapësirë kohe
periodic	periodik-e	lidhur me një periodë ose periudhë të caktuar
periodicals	periodikë-t	botime për periudha të caktuara
periodontal	periodontal-e	që lidhet me mishin e dhëmbëve
periods	perioda-t	
peripheral	periferik-e	1. që lidhet me periferinë; 2. që kryhet në periferi
perishable	1. i shpejtprishshëm; 2. i shpejtkonsumueshëm	që prishet ose konsumohet në një kohë të shkurtër
peritelevision	peritelevizion-i	
peritoneal	peritoneal-e	që lidhet me peritoneumin që mbështjell organet barkore
perlite	perlit-i	eutektoid i formuar nga ferriti dhe çimentiti

permanence	përhershëmëri-a	gjëndje e përhershme dhe e pandërprerë
permanent	i përhershëm	që vazhdon pa ndërprerje
permanently	në mënyrë të përhershme	
permanganate	permanganat-i	kripë e acidit permanganor
permeability	depërtueshmëri-a	aftësia për të përshkuar mjedisin ose pjesë të tij
permeable	i depërtueshëm	që është i aftë të përshkojë mjedisin
permeation	depërtim-i	
permissible	i lejueshëm	që lejohet në kufijtë e caktuar
permit	1. lejoj; 2. lejë	1. i jap mundësi të bëhet
permitted	i lejuar	që është i lejuar të kryhet
permittivity	konstante dielektrike	
peroxide	peroksid-i	përbërje me dy atome oksigjeni në përmbajtje
peroxodisulfate	peroksodisulfat-i	përbërje peroksidi dhe disulfati
peroxomonosulfate	peroksomonosulfat-i	përbërje peroksidi dhe monosulfati
perpendicular	1. pingulisht; 2. pingule; 3. pingule-ja	1. në mënyrë pingule; 2. i pingultë; 3. vijë pingule
persistence	qëndrueshmëri-a	aftësi për të qënë i pandryshueshëm
personal	vetjak-e	që i përket vetë personit
personnel	personel-i	tërësia e personave që kryejnë veprimtari të përbashkët
persons	persona-t	
perspective	1. perspektiv-e; 2. perspektivë-a	1. që ka të bëjë me të ardhmen; 2. e ardhmja e zhvillimit
perspiration	djersitje	proces i sekretimit të djersës
perturbation	trazim-i	lëvizje e çrregullt e elementëve përbërëse të një lënde
pest	dëmtues-i	insekt ose kafshë që dëmton bimët
pesticide	pesticid-i	lëndë kimike për vrasjen e insekteve
pesticides	pesticide-t	
petrochemical	petrokimik-e	që lidhet me lëndët kimike të përftuara nga nafta ose gazi natyror
petrographic	petrografik-e	që lidhet me studimin e shkëmbenjve
petrol	benzinë	lëng i djegshëm që përfitohet nga nafta e që përdoret si lëndë djegëse
petroleum	naftë	vaj mineral nga i cili përfitohen shumë nënprodukte e përdoret si lëndë djegëse
pewter	kallaj-i	lidhje metalike e kallajit me plumbin
pewterware	prodhime kallaji	
pH	pH (pe-hash)	logaritëm negativ i përqendrimit efektiv hidrogjen-jon
phaeodactylum	feodaktul-i	
pharmaceutical	farmaceutik-e	që lidhet me prodhimin dhe shpërndarjen e ilaçeve
phase	fazë-a	1. stad në një proces ndryshimi ose zhvillimi; 2. grup mbështjelljesh gjeneratori
phases	faza-t	
phase-to-earth	fazë-tokë	lidhje e fazës me tokën
phase-to-phase	fazë-fazë	lidhje e fazës me fazën
phasing	1. fazim-i; 2. fazues-e	1. vendosje në fazë; 2. që vendos në fazë
phenol	fenol-i	acid karbolik
phenol-formaldehyde	fenolformaldehid-i	
phenolic	fenolik-e	që lidhet me acidin karbolik

phenols	fenole-t	
phenomena	dukuritë	fakte a ngjarje të vrojuara si shfaqje ligjesh të caktuara
phenoxyalkanoic	fenoksialkanoik-e	
phones	telefona-t	instrumente për të komunikuar nëpërmjet zërit njerëzor
phosphatase	fosfatazë-a	enzimë për fraksionimin e lidhjeve me acidin fosforik
phosphate	fosfat-i	kripë e acidit fosforik
phosphate-bonded	i lidhur me fosfat	
phosphoric	fosforik-e	
phosphorus	fosfor-i	substancë kimike helmuese dyllngjashme që shkëlqen në errësirë dhe i ndezshëm lehtë
phosphovanadomolybdate	fosfovanadomolibdat-i	
photo	fotografi-a	
photochromism	fotokromizëm	sëmundje e shkaktuar nga kromi
photocouplers	fotoçiftëzues-it	
photodarlington	fotodarlington-i	
photodiode-arrays	rrjete diodash	
photodiodes	fotodioda-t	
photographic	fotografik-e	që lidhet me fotografinë
photometric	fotometrik-e	që lidhet me matjen e rrezatimit ndriçues
photomultiplier	fotoshumëfishues-i	pajisje ose aparat për shumëfishime fotografike
photon	foton	njësi e rrezatimit elektromagnetik
photostimulated	i fotostimuluar	i stimuluar me anë të dritës
phototherapy	fototerapi-a	procedurë për kurim sëmundjesh me dritë artificiale
phototransistor	fototranzistor-i	dispozitiv drite me gjysmëpërcjellës për përforsimin e rrymës elektrike
phototransistors	fototranzistorë-t	
photovoltaic	fotovoltaike	i aftë të gjenerojë forcë elektromotore
photovoltaic (PV)	fotovoltaike (FV)	i aftë të gjenerojë forcë elektromotore
phrases	fraza-t	grupe fjalësh të lidhura si pjesë e një fjalie
pH-value	vlerë e pH	
physical	fizik-e	që lidhet me dukuritë e fizikës
physics	fizikë	shkencë që studion dukuritë fizike
physiological	fiziologjik-e	që lidhet me fiziologjinë ose dukuritë fizike
physiotherapy	fizioterapi-a	trajtim i sëmundjeve me masazh, me përdorim të nxehtësisë etj.
pickle	1. banjë acide; 2. dekapirim	2. proces i pastrimit të sipërfaqes me tretës acidë, bazikë.
pick-up	1. mbledhës-i; 2. kapës-i	1. pajisje që mbledh pjesët e mbetura në korije; 2. pjesë kapëse filli
pictograms	piktogram-e-t	gjuhë vizatimore që përmbajnë mesazhe të caktuara
pictorial	1. i ilustruar; 2. grafik-e	1. që është me ilustrime; 2. e paraqitur me grafikë
picture	imazh-i	shëmbëllim i një objekti
pictures	imazhe-t	
pie	piezoelektrik-e	
piece	copë	pjesë e shkëputur nga një e tërë
pieces	copa-t	
piercing	shpues-e	që shërben për shpim
piezoelectric	piezoelektrik-e	
pig-irons	giza-t	forma hekuri të papastërta me përzierje karboni



pigment	pigment-i	lëndë ngjyruese
pigments	pigmente-t	
pigtailed-style	stil gërshtet	
pile	shtyllë	
piles	shtylla-t	
piling	shtyllnajë-a	radhë shtyllash në një armaturë
pilot	pilot-i	kontroll nga një qendër
pin	1. kunj-i; 2. spinot; 3. pern; 4. spinë	përgjithësisht detal në formë kunjii rrethor
pinch	vetëzgjatje-a (pinçim)	zgjatje procesi në shkarkim
pinces	pisha-t	dru pyjorë halorë me frute boçe
pi-network	katërpolar-i $\pi$	katërpolar pigrak ( $\pi$ )
pinhole	dritarëz-a	hapësirë në formë vrime
pinholes	dritarëza-t	
pin-index	1. indeks i impulsit; 2. indeks i daljes	
pinnacles	Pinakles	informacion Pinakles në libraritë e taguara (simbolizuara)
PIN-photodiodes	fotodioda-t PIN	
pins	1. kunj-t; 2. spinota-t; 3. perna-t; 4. spina-t	
pipe	tub-i	
pipelayers	tubashtruese-ja	makinë për shtrim tubash
pipeline	tubacion-i	tub i gjatë i përbërë nga shumë pjesë ose sistem tubash të bashkuar
pipelines	tubacione-t	
pipes	tuba-t	
pipettes	pipeta-t	gypës i shkurtër në punët laboratorike
pipework	sistem tubash	
piping	1. tubëzues-e; 2. tubacion	2. sistem tubash të bashkuar
piston	piston	detal cilindrik i shkurtër që zhvendoset brenda një cilindri
piston-operated	që punon me piston	
pit	gropëz	e thelluar e vogël e krijuar nga korrodimi
pitch	hap-i	largësi ndërmjet të ngriturave të filetave
pitons	bulonë me vath	lloje bulonësh me varës për ngritje ngarkesash
pitting	korrodim pikësor	lloj korrodimi në pika të caktuara
pivot	1. çernierë-a; 2. grusht kthimi	1. lidhje dylementëshe që rrotullohen rreth një aksi
pivoted	i çernieruar	që është lidhur ose punon me çernierë
placed	i vendosur	që është vënë në një vend të caktuar
places	vende-t	pjesë e caktuar hapësire e zënë nga një objekt
plain	i thjeshtë	i pa zbukuruar me lajle
plan	plan-i	skicë paraqitëse e pjesëve të objektit, të përmasave etj.
planar	rrafshor-e	1. që ka të bëjë me rrafshin; 2. i paraqitur në rrafsh
plane	1. rrafsh-i; 2. faqe	sipërfaqe gjeometrike me përmasa të caktuara
planers	1. zdruathuese-t; 2. rula-t ngjeshës	1, makina që shërbejnë për zdrukthim; 2. makinë ruluese-ngjeshëse
plane-strain	shformim rrafshi	
planetary	1. planetar-e; 2. planetar-i	1. që bën rrotullim planetar; 2. rrotë planetare

planetary-mixer	përzierës me planetar	
planing	zdrugthyes-e	që shërben për zdrukthim
planning	1. planëzues-e; 2. planëzim	1. që paraqet në plan; 2. paraqitje në plan
plans	plane-t	
plant	impiant-i	1. makineri për prodhim industrial; 2. tërësi pajisjesh dhe aparaturash
plants	impiante-t	
